



### Thirrje për aplikim:

#### Grante për projekte të vogla nga Ambasada Gjermane në Prishtinë

#### **Çfarë janë grantet për projekte të vogla?**

Grantet për projekte të vogla nga Ambasada Gjermane në Prishtinë kanë për qëllim të sigurojnë ndihmë të shpejtë dhe efektive për shtresat më të varfëra dhe / ose grupet më të cenueshme të shoqërisë.

#### **Kush ka të drejtë të aplikojë?**

Të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Kosovë kanë të drejtë të aplikojnë. Individët, kompanitë dhe start-up bizneset nuk do të përkrahen.

#### **Cilat janë kriteret?**

Projekt-propozimi:

- Nga projekti duhet të përfitojnë shtresat më të varfëra dhe / ose grupet më të cenueshme të shoqërisë.
- Projekti nuk mund të tejkalojë shumën e grantit prej 8.000 Euro;
- Projekti nuk mund të përfshijë shpenzime për personel/staf;
- Projekti nuk mund të rezultojë në shpenzime recidive (p.sh. shpenzime për karburant, ushqim, barëra, materiale të ndryshme etj.);
- Projekti mund të përmbyllet brenda vitit kalendarik 2020.

#### **Në çfarë fokusohet thirrja për aplikim këtë vit?**

- Në projekte që mbështesin persona me nevoja të veçanta;
- Në projekte me ndikim të gjerë shoqëror;

Gjithashtu do të merren në konsideratë edhe projektet që fokusojnë fusha të tjera.

## **Cila është procedura për dorëzimin e projekt-propozimit dhe kur është afati i fundit?**

Projekt-propozimi duhet të përmbajë këto dokumente:

- Një formular të plotësuar të aplikimit (mund ta shkarkoni në linkun vijues: <https://t1p.de/kp2020a>)
- Një plan financiar të projektit (pjesa që vetëfinanconi, financimi që mbulohet nga një palë e tretë dhe pjesa që kërkoni të mbulohet nga ambasada) në formë tabelare dhe me detaje për shpenzimet përkatëse;
- Dy pro faktura (dy oferta për pajisjet dhe/ose koston e shërbimeve të kërkuara; të përkthyer në gjuhën gjermane ose angleze);
- Një kopje e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
- Nënshkrimet e dy menaxherëve të projektit (nëse projekt-propozimi dorëzohet në mënyrë elektronike, atëherë nënshkrimet duhet të skanohen).

Afati i fundit për dorëzimin e projekt-propozimeve është data **9 mars 2020, ora 12:00**.

Projekt-propozimet mund të dorëzohen në mënyrë elektronike në: [info@diplo.pris.de](mailto:info@diplo.pris.de) ose **përmes postës si kopje fizike** në adresën vijuese:

Ambasada Gjermane në Prishtinë

Seksioni për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

Rr. Azem Jashanica nr. 66, Dragodan II

10000 Prishtinë

TEL + 383 (0) 38 2545-00

FAX + 383 (0) 38 2545-36